



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 242

Tiranë – E premte, 16 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 58, datë 5.12.2016	
Për shpalljen e thirrjes për financimin e nënprogramit “Mbështetja financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, Programi i Mbështetjes për Ekonominë, Shtylla II.....	24515

**VENDIM****Nr. 58, datë 5.12.2016**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR
FINANCIMIN E NËNPROGRAMIT
“MBËSHETJJA FINANCIARE PËR
NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË
MESME”, PROGRAMI I MBËSHETJES
PËR EKONOMINË, SHTYLLA II**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve dhe të VKM nr. 580, datë 3.8.2016 “Mbi krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për financimin e nënprogramit “Mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, Programi i Mbështetjes për Ekonominë, Shtylla II.

2. Drejtimit e nënprogramit janë për skema granti që:

a) nxisin zhvillimin ekonomik lokal e rajonal dhe punësimin, përmes krijimit dhe transformimit të zonave të përmirësuara të biznesit, si masë shoqëruese në zona ku kryhen investime infrastrukturore nga Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, Granti “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, duke rritur potencialin e tyre të konkurrueshmërisë rajonale, dhe aktivizimin e kapitaleve, si:

i) pazaret, tregjet, markatat, njësitë ekonomike;
ii) rrugët tregtare, bulevardet, pedonalet, sheshet;

iii) zonat rrotull atraksioneve historike, të trashëgimisë kulturore, kalave; objekteve me rëndësi kombëtare;

iv) zonat e rehabilituara pranë burimeve ujore dhe natyrore, me potencial turistik dhe shërbimesh.

b) mbështetjen e projekteve të njëjse ekonomike të njëjse të qeverisjes vendore, për

rigjallërimin e aktivitetit ekonomik dhe poleve të zhvillimit lokal/rajon, në funksion të krijimit të punësimit dhe të ardhurave shtesë, të cilat do të ripërdoren për zhvillimin ekonomik të zonës së tyre.

3. Aplikimi për financimin e nënprogramit, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet nga Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedura e vlerësimit të nënprogramit të aplikuar, kryhet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe propozimi i paraqitet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi**

Zëvendëskryeminstri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Shtojca I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË NËNPROGRAMIT

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për financimin e nënprogramit sipas pikës 1, të këtij vendimi.
20 Dhjetor	Aplikuesi sipas pikës 3, të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi i aplikimit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
2 (dy) ditë nga mbyllja e aplikimit	MZHETS	Vlerësimi përputhshmërisë së nënprogramit, sipas kriterëve të shtojcës III.
	MZHETS	MZHETS paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm propozimin për nënprogramin fitues, për tja përcjell Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR	Në bashkëpunim me MZHETS organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

**Shtojca II:****FORMATI I APLIKIMIT PËR NËNPROGRAMIN****Ky format plotësohet për të gjitha nënprogramet**

Aplikuesi/Autoriteti Menaxhues (*)	
Data e aplikimit (*)	
Titulli i nënprogramit (*)	
Shtylla e financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet. (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Data e fillimit të nënprogramit (*)	
Data e mbarimit të nënprogramit (*)	
Përshkrimi i nënprogramit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i nënprogramit të propozuar për financim.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i nënprogramit si dhe objektivat specifike të tij.
Përfituesit (*)	Të jepen një informacion mbi subjektet përfituese nga ky nënprogram.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	
Kostoja totale e nënprogramit (*)	
Dokumentat shoqëruese (*)	Propozimi duhet të ketë pjesë të tij: - Nënprogramin e mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme - Vendimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, për miratimin e skemave të financimit të nënprogramit

SHËNIM: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimi për nënprogramin bëhet:

- a) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

**Shtojca III:****KRITERET E VLERËSIMIT TË NËNPROGRAMIT QË PROPOZOHET PËR FINANCIM****A. Kriteret e vlerësimit të nënprogramit**

Këto kriteret përdoren nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për të vlerësuar nënprogramin e paraqitur për vlerësim, dhe mund të detajohen në nënkritere përkatëse. Vlerësimi ka **maksimalisht 100 pikë**.

Kriteret për vlerësimin e nënprogramit që propozohet për financim, si më poshtë vijon:

1. Përputhja e nënprogramit me politikën, drejtimit e thirrjes, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**
2. Niveli i impaktit në zhvillimin ekonomik, lokal e rajonal, rritjen e punësimit dhe të zinxhirit të vlerës. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
3. Potenciali i ndikimit në vlerën e shtuar të investimeve që kryhen në infrastrukturën publike lokale dhe rajonale, përmes Grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, në zonën ku do të veprojnë skemat e nënprogramit. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
4. Ndikimi në vlerën e shtuar, tërheqjen e investimeve, përmes bashkëfinancimit, gjenerimit të projekteve të reja, përmirësimit të shërbimeve, etj. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
5. Ndikimi në krijimin e bizneseve të reja, fuqizimin, diversifikimin e bizneseve, me ndikim në përmirësimin dhe zhvillimin e zonës përkatëse ku kryhet investimi, dhe të konkurrueshmërisë rajonale. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë